



Prishtinë, 29 mars 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_928\_2018

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 13 par 1 dhe nenin 14 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja bazuar në BRE;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 paragrafi 7, 8, 9 dhe 10, nenin 8 paragrafi 3 dhe 4, nenin 9, neni 11 dhe nenin 12 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve;
- Vendimin nr. V\_810\_2016 dt. 19 maj 2016 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, Wind Park – Zatric 2, në vendin e quajtur Zatric, ZK Zatric dhe ZK Kaznik, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, në Komunën e Rahovecit, të datës 27.10.2017 nr. prot. 418/17 të shoqërisë “EV Wind Park ” SH.P.K., me adresë: Sheshi “Sadik Shala”, Rahovec, Republika e Kosovës, dhe
- Aplikacionin për Pranin në Skemën Mbështetëse;

në seancën e mbajtur me datë 29 mars 2018 nxori këtë:

## V E N D I M

### Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se shoqëria “EV Wind Park” SH.P.K., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, Wind Park – Zatric 2, në vendin e quajtur Zatric, ZK Zatric dhe ZK Kaznik, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, në Komunën e Rahovecit, Republika e Kosovës.
- II. Aplikuesit “EV Wind Park ” SH.P.K., do t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenin 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.



- III. Vendimi për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi dhe ti lëshohet Autorizimi Final në përputhje me Rregullën e Autorizimit.
- IV. Vendimi për Autorizimin Preliminar përcakton se, procesi për pranim në skemën mbështetëse do të ndalohet derisa, të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës.
- V. Me Vendimin për Autorizimin Preliminar përcaktohet se aplikacioni i shoqërisë "EV Wind Park " SH.P.K., konsiderohet si aplikacion "në pritje", për pranim në skemën mbështetëse.
- VI. Vendimi për Autorizimin Preliminar lëshohet për periudhën dymbëdhjetë (12) mujore, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II. të dispozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkojë lëshimin e Autorizimit Final për ndërtim të stabilimenteve të reja gjeneruese.
- VII. Afati i Vendimit për Autorizimin Preliminar i përcaktuar me dispozitivin nën pikën VI. i këtij vendimi, do të fillojnë të rrjedh, jo nga data e lëshimit të këtij vendimi, por nga data e njoftimit me shkrim nga ZRRE për përfshirje në skemën mbështetëse.

## Arsyetim

- ZRRE me datë 27.10.2017 nga shoqëria "EV Wind Park " SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapacitetit të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA Wind Park – Zatric 2, në vendin e quajtur Zatric, ZK Zatric dhe ZK Kaznik, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, në Komunën e Rahovecit, Republika e Kosovës.
- ZRRE me datë 27.10.2017 nga shoqëria "EV Wind Park " SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse.
- ZRRE- me datë 02.02.2018 i ka lëshuar njoftimit shoqërisë "EV Wind Park " SH.P.K., ku ka theksuar se: ZRRE ka pranuar/evidentuar disa aplikacione për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga ERA ku kapaciteti i të cilave ka PËRMBUSHUR caqet për shfrytëzimin dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE-të, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2017 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Po ashtu ka njoftuar se me Rregullën për Pranim në Skemën Mbështetëse tarifa nxitëse "Feed in" do ju garantohet vetëm aplikuesëve që kanë marr Autorizim Preliminar apo Final që janë brenda caqeve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 05/2017.
- ZRRE në njoftimin përkatës ka njoftuar se: nëse aplikuesi dëshiron të vazhdojë me procedurat për marrjen e Vendimit për Autorizimin Preliminar apo Autorizimin Final, në vendimin përkatës do të specifikohet se procesi për pranim në skemën mbështetëse do të ndalohet derisa të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017, dhe ka sqaruar se ZRRE do e njoftoj aplikuesin sipas rendit të aplikacioneve me rastin e lirimit të caqeve të disponueshme.
- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe vlerësimit të përmbajtjes së




aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**VIII.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**IX.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Rahovecit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së